



**REPUBLIKA E KOSOVËS /
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO**

C.nr.1429/15

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, si gjykatë civile e shkallës së parë, trupi gjykues në përbërje prej gjyqtarit Lumni Sallauka- kryetar dhe gjyqtarëve porot Sadife Arenliu dhe Njazi Elezkurtaj - anëtar, me procesmbajtësen Raxhije Emini, në çështjen juridike të paditësit A. G. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. R. T. nga Prizreni, kundër të paditurës K. G., e lindur C. nga Prizreni, me banim në shtetin e Gjermanisë, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm av. F. J. nga Prizreni, për shkak të zgjidhjes së martesës, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor jo publik, me datën **28.12.2016**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit A. G. nga Prizreni, **si e bazuar**.

II. ZGJIDHET me shkurorëzim martesë, e lidhur në mes paditësit A. G. nga Prizreni dhe të paditurës K. G., e lindur C. nga Prizreni, e lidhur me datën ..., në zyrën e gjendjes civile në Prizren, e regjistruar me nr. rendor ... dhe me nr. të referencës

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi A. G. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tij av. R. T., në Gjykatën Themelore në Prizren ka parashtruar padi, kundër të paditurës K. G., e lindur C. nga Prizreni, tani me banim në shtetin e Gjermanisë, me objekt të padisë zgjidhjen e martesës.

I autorizuari i paditësit av. R. T. në shqyrtimin kryesor deklaroi se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadiës, duke shtuar se palët ndërgjyqëse këtë martesë e kanë lidhur me datën ..., në zyrën e gjendjes civile në Prizren, e regjistruar me nr. rendor ... dhe me nr. të referencës ... Më tutje ka shtuar se paditësi me të paditurën kanë jetuar së bashku deri me datë 07.03.2015, datë kur e njëjta ka shkuar të jetojë në Gjermani me paditësin, mirëpo pas 2-3 ditësh e paditura ka ikur nga banesa e paditësit dhe që nga kjo kohë paditësi nuk ka pasur kontakt me të njëjtën. Nga kjo martesë palët ndërgjyqëse nuk kanë lindur fëmijë. Meqenëse martesë në mes palëve ndërgjyqëse faktikisht ka pushuar së ekzistuari dhe se e njëjta ka humbur qëllimin për të cilin është lidhur, i ka propozuar gjykatës që pas zhvillimit të procedurës të zgjidhë martesën e lidhur me shkurorëzim. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Përkundër faktit që e paditura është ftuar për të marr pjesë në shqyrtimin kryesor për datën 27.10.2016, përmes kanaleve diplomatike (të njëjtës i janë dorëzuar të gjitha provat materiale së bashku me aktvendimin për të dhënë përgjigje në padi), e njëjta nuk është paraqitur fare në këto shqyrtim, si dhe nuk ka parashtruar përgjigje në padi. Përkatësisht gjykata me shumë vonesë e ka marr konfirmimin nga Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar, se e paditura e ka pranuar ftesën për shqyrtim kryesor, më saktësisht këtë njoftim gjykata e ka pranuar me datën 13.12.2016, që do të thotë pas datës së caktuar për seancë (27.10.2016). Për shkak të këtyre rrethanave, gjykata ka aprovuar kërkesën e palës paditëse të bërë në shqyrtimin e datës 27.10.2016 dhe të paditurës konform nenit 79 parag.3 pika b) të LPK-së, i ka caktuar përfaqësuesit e përkohshëm dhe atë av. F. J., pasi ka ardhur në përfundim se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurës av. F. J., në shqyrtimin kryesor deklaroi se mbetet në tërësi si në të cekurat në përgjigje në padi, përmes së cilave e kundërshton në parim kërkesëpadinë e paditësit, ndërsa ka shtuar se përkundër përpjekjeve nuk ka arritur të kontaktojë me të paditurën. Në fund ka deklaruar se e lë në vlerësim të gjykatës të vendos për zgjidhjen e martesës me shkurorëzim ose jo. Shpenzimet i ka kërkuar.

Meqenëse të dy palët ndërgjyqëse aktualisht janë me vendqendrim në Republikën e Gjermanisë, bazuar në nenin 76 par.1 pika (1) të Ligjit për Familjen i Kosovës (LFK), gjykata nuk ka mbajtur seancë pajtimi.

Në këtë drejtim gjykata gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin dhe vlerësimin e këtyre provave: çertifikatën e martesës nr. rendor ..., dt.... dhe deklaratën e noterizuar të prindërve të paditësit të datës 18.11.2016.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palës paditëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit **është e bazuar**.

Nga leximi i çertifikatës së martesës me nr. rendor ..., dt...., të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës, gjykata ka konstatuar faktin e lidhjes së martesës në mes të A. G. dhe K. G. e lindur C., martesë kjo e lidhur me datën ..., pranë Zyrës së Ofiqarisë në Komunën e Prizrenit.

Sipas nenit 68 par. 1 të Ligjit për Familjen (LFK) është e paraparë se *“martesa mund të zgjidhet me shkurorëzim vetëm në bazë të vendimit të gjykatës”*. Me paragrafin 2 të këtij neni parashihet se *“njëri apo të dy bashkëshortët me marrëveshje të dyanshme mund të kërkojnë shkurorëzim duke parashtruar padi në gjykatën kompetente”*. Me nenin 69 të LFK-së, parashifet se *“bashkëshorti mund të kërkojë shkurorëzim kur mardhëniet martesore janë çrregulluar seriozisht, ose në mënyrë të vazhdueshme, ose për shkaqe të tjera është zgjidhur në mënyrë të pakthyshme. Shkaqet e shkurorëzimit janë mesë tjerash: jeta e padurushme e bashkëshortëve, shkelja e besnikërisë bashkëshortore, veprat penale kundër të jetës së bashkëshortit, keqëtrajtimi serioz, lënia qëllimkeqe dhe e pa arsyeshme, sëmundja psikike e pa shërueshme dhe pa aftësija e vazhduar për të vepruar, ndërprerja e pa arsyeshme e jetës faktike për më shumë se një vit, si dhe shkurorëzimi me marrëveshje të dy anëshme”*.

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave materiale të cilat janë elaboruar më lartë, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe e njëjta duhet të aprovet në tërësi. Kjo për faktin se nga deklaratimet e të autorizuarit të paditësit dhe deklaratës së noterizuar të prindërve të paditësit të datës 18.11.2016, paditësi me të paditurën që një kohë relativisht të gjatë (që nga data 07.03.2015), nuk jetojnë në bashkësi faktike. Andaj, përfundimisht gjykatës i ka rezultuar se në rastin konkret është humbur njëri prej elementeve të martesës të parapara me Ligjin e Familjes së Kosovës, i cili është *“jeta e përbashkët e bashkëshortëve”*, ku si rrjedhojë konform nenit 69 parag.2 të Ligjit për Familjen të Kosovës, janë plotësuar kushtet ligjore për ta zgjidhur martesën me shkurorëzim.

Të paditurës K. G. e lindur C., edhe pse i është dhënë mundësia që të marrë pjesë në shqyrtimin kryesor, ku edhe eventualisht do t'i parashtronte pretendimet e saj, e njëjta siç e kemi cekur edhe më lartë nuk është paraqitur fare në gjykatë, si dhe nuk i ka parashtruar pretendimet e saj përmes përgjigjes në padi (siç e kemi cekur më lartë gjykata ka marrë konfirmim nga Ministria e Drejtësisë se të paditurës autoritetet gjermane i kanë dorëzuar ftesën për shqyrtim kryesor dhe dokumentacionin përcjellës për seancën e datës 27.10.2016, e që do të thotë se e njëjta është në dijeni të zhvillimi të kësaj procedure, mirëpo nuk ka parashtruar ndonjë mjet juridik për kundërshtimin e kërkesëpadiës së paditësit).

Gjykata konform nenin 450 të LPK-së vendosi që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale, për faktin se i autorizuari i paditësit deklaroi në shqyrtimin kryesor se nuk i kërkon të njëjtat. Ndërsa konform dispozitave përkatëse ligjore përfaqësuesit të përkohshëm i janë njohur shpenzimet e procedurës sipas TA-së, pasi që paraprakisht pala paditëse në bazë të vendimit të gjykatës e ka deponuar shumën prej 400 eurove në llogari të gjykatës në emër të shpenzimeve për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm. Kjo shumë me aktvendimin e datës 29.12.2016, i është bartur në llogari të av. F. J.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së, në lidhje me nenin 68, 69, të Ligjit për Familjen të Kosovës (LFK).

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.1429/15, datë 28.12.2016

Procesmbajtësja,
Raxhije Emini

Kryetari i trupit gjykues,
Lumni Sallauka

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur, ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite pas pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj Gjykate.